



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 352 prot.

Tiranë, më 03.02.2026

Lënda: Raport i realizimit të detyrave për periudhën janar-dhjetor 2025

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Adresa: Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë

Të nderuar,

Në mbështetje të gërmës c, të pikës 6, të VKM nr. 325 datë 18.05.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, në vijim Ju përcjellim raportimin e realizimit të detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për periudhën janar-dhjetor 2025.

1. Rishikimi i legjislacionit për metrologjinë dhe përafrimi me acquis të BE

Gjatë vitit 2025, DPM ka punuar për përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e metrologjisë, si dhe për përafrimin e tij me legjislacionin europian. Krahas kontributeve për Kapitullin I të PKABE dhe Planit të Veprimit për adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit I, si dhe të Planit të veprimit për adresimin e neneve 34-36 të TFBE, DPM ka raportuar periodikisht lidhur me statusin e përmbushjes së masave të prashikuara në këto plane.

Konkretisht, gjatë vitit 2025 në zbatim të Urdhërit të Brendshëm nr. 89, datë 28.03.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e akteve nënligjore në kuadër të Ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, janë hartuar dhe dërguar për miratim pranë Ministrisë projektaktet e mëposhtme:

1. Projektvendimi “Për miratimin e rregullores për realizimin e kalibrit të etaloneve të matjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”.
2. Projektudhëzimi i përbashkët i ministrave për ekonominë dhe financat “Për pagesat dhe tarifatat e shërbimeve për metrologjinë, si dhe për mënyrën dhe afatet e parapagimit të tyre”.
3. Projekturdhëri “Për miratimin e rregullores për miratimin e tipit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara”.
4. Projekt urdhëri i ministrit “Për përshkrimin e shenjës dalluese “instrument matës jo në përdorim sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për metrologjinë”.

Me mbështetjen e projektit “Programi Global për Cilësinë dhe Standardet – Shqipëria” (GQSP) të UNIDO-s, në periudhën 25-29 gusht 2025 DPM zhvilloi një ëorkshop me qëllim analizën dhe vlerësimin e legjislacionit aktual kombëtar në fushën e metrologjisë. Ky proces synoi identifikimin e mangësive dhe mospërputhjeve të mundshme me acquis të BE-së, si dhe formulimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor. Rekomandimet e ekspertës ndërkombëtare do të reflektohen në aktet nënligjore që janë në proces rishikimi, me qëllim përputhshmërinë e plotë të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në fushën e metrologjisë. Këto rekomandime do të reflektohen gjatë procesit të draftimit të amendimeve të planifikuara në periudhën 2026-2027.

Realizimi i detyrave në kuadër të Integritimit Evropian (GNPIE) – Kapitulli I: “Lëvizja e lirë e mallrave”

Gjatë vitit 2025, DPM ka kontribuar në përmbushjen e kërkesave të Komisionit Evropian dhe strukturave koordinuese në MEI në kuadër të procesit të integritimit evropian, me fokus në metrologji.

- **Adresimi i piketave mbyllëse për Kapitullin I:** Është hartuar dhe rishikuar Plani i Veprimit për adresimin e Piketave mbyllëse për Kapitullin I “Lëvizja e lirë e mallrave”, duke përfshirë masa ligjore për përafrimin me acquis të BE-së, si dhe masa institucionale dhe administrative për forcimin e kapaciteteve teknike dhe administrative të DPM. Pas miratimit të këtij plani DPM ka raportuar sistematikisht në MEI në kuadër të monitorimit periodik të zbatimit të masave të planifikuara.
- **Hartimi i Planit të Veprimit për Kapitullin III “Shërbimet”:** Plani i Veprimit për metrologjinë në Kapitullin III është hartuar dhe dorëzuar pranë strukturave koordinuese në MEKI.
- **Kontribut për raportet e progresit në lidhje me çështjet e integritimit evropian:** DPM ka raportuar rregullisht progresin për monitorimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE) 2024–2026.
- **Monitorimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030:** Është hartuar raporti i progresit për zbatimin e strategjisë dhe është dorëzuar pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministri. Gjithashtu, është përgatitur raporti për vlerësimin e Indeksit të SME-ve, në kuadër të projektit të OECD për Evropën Juglindore (Maj–Korrik 2025).

2. Mbrojtja e konsumatorëve nga matjet e pasakta - Realizimi e treguesve teknikë dhe ekonomikë

Objektivi për mbrojtjen e konsumatorëve nga matjet e pasakta është përmbushur me sukses gjatë vitit 2025. Në zbatim të planeve të punës të miratuara, ishte planifikuar verifikimi i 40 166

instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, ndërsa u verifikuan 42 312 instrumente, duke shënuar një realizim prej 105.3% të planit.

Në krahasim me vitin 2024, kur u verifikuan 39 735 instrumente matëse, gjatë vitit 2025 numri i instrumenteve të verifikuar është 42 312, e cila përfaqëson një rritje prej 6.5%. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e shërbimeve të verifikimit gjatë vitit 2025 rezultuan 11.9% më të larta krahasuar me vitin e mëparshëm, duke reflektuar rritje të performancës dhe eficiencës së shërbimit.

Gjatë periudhës raportuese, janë kalibruar gjithsej 2462 instrumente matëse, nga këto, 1489 instrumente (60,4%) i përkasin subjekteve të jashtme, ndërsa 973 instrumente i përkasin vetë DPM. Nga laboratorët të cilët kanë deklaruar aftësitë matëse dhe kalibruese (CMC) në databazën e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM), janë lëshuar gjithsej 391 certifikata kalibrimi me logon ndërkombëtare CIPM MRA.

Në total, gjatë vitit 2025 janë verifikuar dhe kalibruar 44 774 instrumente dhe pajisje matëse në masën 108.4 % krahasuar me planin, ndërsa të ardhurat nga këto shërbime janë realizuar në masën 74 704 406 lekë (pa TVSH), ose 103% krahasuar me planin.

Në sezonin veror 2025, DPM organizoi grupe të posaçme pune për verifikimin e instrumenteve matëse që përdoren nga subjektet sezonale përgjatë vijës bregdetare. Këto masa u ndërmorën për të mbështetur bizneset sezonale dhe për të siguruar respektimin e standardeve metrologjike.

Gjatë vitit 2025 janë kryer autorizime / monitorime të subjekteve të autorizuara që ushtrojnë veprimtari në fushën e metrologjisë ligjore, në zbatim të urdhrit të Ministrit nr. 149, datë 19.05.2022, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe për monitorimin e aktivitetit dhe performancës së tyre”. Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë marrë tre vendime për riautorizimin e subjekteve juridike për ushtrimin e veprimtarisë në metrologjinë ligjore, një autorizim i ri, një vendim për shtim kapaciteti, një revokim autorizimi, si dhe shfuqizimi i një vendimi administrativ. Gjatë vitit janë realizuar gjithsej 12 vizita monitoruese në subjektet e autorizuara nga DPM, ndërkohë që dy subjekte kanë qenë me aktivitet të pezulluar. Raportet përfundimtare të monitorimeve përmbajnë analizën e gjetjeve dhe rekomandime konkrete për përmirësime të mëtejshme, me qëllim rritjen e cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë së shërbimeve metrologjike në nivel kombëtar.

3. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe kompetencës teknike

i. Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit sipas standardit SSH EN ISO/IEC 17025:2017 - për kompetencën teknike të laboratorëve testues dhe kalibrues

Gjatë vitit 2025, DPM ka rishikuar dhe përmirësuar të gjithë dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, në përputhje të plotë me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017, e cila përfshin përditësimin e procedurave, protokolleve, politikave dhe dokumenteve të tjera mbështetëse, me qëllim forcimin e kompetencës teknike dhe sigurimin e besueshmërisë së rezultateve laboratorike. DPM ka operuar në përputhje me Marrëveshjen e Njohjes Ndërkombëtare të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (CIPM MRA), e cila garanton njohjen reciproke të rezultateve të matjeve dhe kalibrimeve ndërmjet vendeve anëtare.

Në zbatim të programit vjetor të auditimeve të brendshme të sistemit të menaxhimit të cilësisë (DPM-FO-06/1-2025), janë planifikuar, organizuar dhe dokumentuar auditimet e brendshme në laboratorët e Drejtorisë të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale. Qëllimi i këtyre auditimeve ka qenë vlerësimi i nivelit të zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorët kalibruar, verifikimi i përputhshmërisë me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017, si dhe identifikimi i mundësive për përmirësim të vazhdueshëm të proceseve në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

Gjatë vitit 2025 dy laboratorë, përkatësisht laboratorit i matjeve elektrike dhe i matjeve dimensionale, kanë filluar procesin e pjesëmarrjes në krahasime ndërlaboratorike të organizuara në nivel evropian nga organizata EURAMET, me qëllim sigurimin e vlefshmërisë së rezultateve të matjeve dhe kalibrimeve që ofrojnë.

Në kuadër të demonstrimit dhe përmbushjes formale të kërkesave për kompetencë teknike të laboratorëve, DPM ka paraqitur aplikim pranë një organi akreditues jashtë vendit, me qëllim njohjen ndërkombëtare të shërbimeve të tij. Ky aplikim synon akreditimin sipas standardit ISO/IEC 17025:2017, si laborator kalibrimi, në tre fusha matjeje, konkretisht: temperaturë, matje elektrike dhe matje dimensionale.

ii. Implementimi i standardit SSH EN ISO/IEC 17020:2012 në metrologjinë ligjore dhe aplikimi për akreditim

Në funksion të objektivit për implementimin e kërkesave të standardit SSH EN ISO/IEC 17020:2012 “Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për funksionimin e organeve të ndryshme që kryejnë inspektim”, me qëllim vlerësimin e kompetencës teknike dhe rritjen e njohjes ndërkombëtare të veprimtarisë së DPM në fushën e verifikimit të instrumenteve matëse - objekt i kontrollit metrologjik ligjor, është hartuar gjithë paketa e dokumentacionit të sistemit të menaxhimit që përfshin mbi 15 procedura operacionale dhe teknike.

Implementimi i kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012 është shtrirë në sektorët e shërbimit të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore në rrethe. Dokumentacioni i miratuar është vënë në dispozicion të personelit, i cili është trajnuar me qëllim zbatimin efektiv dhe të unifikuar të tij në veprimtarinë e përditshme për regjistrimin dhe dokumentimin e proceseve të verifikimit të

instrumenteve matëse të peshimit jo-automatik, me synim rritjen e transparencës, përmirësimin e gjurmueshmërisë së veprimtarisë verifikuese dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

Në përputhje me objektivat e planifikuara për vitin 2025 dhe si rezultat i konsolidimit të dokumentacionit dhe zbatimit të Sistemit të Menaxhimit sipas ISO/IEC 17020:2012, është realizuar aplikimi zyrtar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) për akreditimin e DPM, për herë të parë, si organ inspektues për kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve të peshimit jo-automatik në përdorim.

iii. Implementimi i standardit SSH EN ISO/IEC 17065:2012 - për certifikimin e produkteve të parapaketuara me shenjë konformiteti

Në funksion të përgatitjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) për të vepruar si trupë certifikuese në përputhje me standardin SSH EN ISO/IEC 17065:2012, gjatë periudhës raportuese është hartuar një plan i detajuar veprimi, që përcakton hapat konkret për ndërtimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në këtë fushë. Ky proces ka për qëllim certifikimin e linjave të paketimit të produkteve të parapaketuara dhe vendosjen e shenjës evropiane të konformitetit “e”, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të BE-së për parapaketimet. Dokumentacioni përkatës pritet të finalizohet brenda vitit 2025, duke krijuar bazën për akreditimin dhe njohje ndërkombëtare të DPM, si organ certifikues, në këtë fushë.

iv. Zbatimi i projektit për barazi gjinore të UNECE

DPM përfiton asistencë teknike nga projekti i financuar dhe zbatuar nga UNECE (Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën), në lidhje me “Mundësimin e gjithëpërfshirjes përmes integritetit gjinor në infrastrukturën e cilësisë për tregtinë”. Në bashkëpunim me projektin u hartua dhe miratua “Plani i veprimit për barazi gjinore në DPM 2025-2028”, që do të zbatohet gjatë viteve në vazhdim.

v. Pjesëmarrje në Programe dhe aktivitete ndërkombëtare për zhvillimin e kapaciteteve teknike

DPM u përfaqësua në Programin për Zhvillimin e Kapaciteteve (Capacity Building Programme), të organizuar nga Byroja Ndërkombëtare e Peshave dhe Masave (BIPM), në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Metrologjisë të Turqisë (UME). Qëllimi i këtij programi ishte forcimi i kapaciteteve teknike për sigurimin e gjurmueshmërisë në nivel primar, në fushën e temperaturës.

Gjatë vitit, punonjësit e DPM morën pjesë në një sërë aktiviteteve trajnuese të organizuara nga vetë DPM, nga ASPA, si dhe në aktivitete trajnuese të zhvilluara në kuadër të projekteve të bashkëpunimit me UNIDO-n.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve teknike, menaxhuese dhe profesionale të stafit, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar trajnime të ndryshme, përfshirë edhe pjesëmarrjen e stafit në trajnime ndërkombëtare dhe praktikë metrologjike pranë Institutit Kombëtar të Metrologjisë të Turqisë (UME).

vi. Këshilli i Metrologjisë

Gjatë vitit 2025, Këshilli i Metrologjisë është mbledhur dy herë, konkretisht në muajin Shkurt dhe Korrik, duke vazhduar më forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve të përfaqësuara në këtë organ këshillimor. Gjithashtu, është në proces përditësimi i anëtarësisë së Këshillit të Metrologjisë, në përfundim të mandatit të parë, 3-vjeçar.

4. Realizimi i treguesve financiarë dhe buxhetit për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, DPM ka ushtruar veprimtarinë e tij në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar, duke garantuar menaxhimin financiar dhe kontabël të institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Janë përgatitur dhe mbyllur llogaritë vjetore për vitin 2024, përfshirë pasqyrat e bilancit dhe dorëzimin e tyre pranë Degës së Thesarit dhe ministrisë përgjegjëse, si dhe është hartuar dhe zbatuar plani i limitit të arkës për vitin 2025. DPM ka administruar kontabilizimin mujor të të ardhurave dhe shpenzimeve në sistemet AFMIS, e-Filling dhe e-Invoice, ka deklaruar detyrimet tatimore dhe kontributet shoqërore brenda afateve ligjore, ka përgatitur listëpagesat e punonjësve dhe ka ndjekur pagesat që burojnë nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Gjithashtu, është realizuar administrimi i magazinës dhe i aktiveve të qendrueshme, procesi i inventarizimit fizik dhe shkarkimi kontabël i aktiveve jashtë përdorimit, si dhe monitorimi i shpenzimeve korrente dhe investimeve, duke siguruar rakordim të vazhdueshëm me Degën e Thesarit dhe korrektësi në raportimin financiar institucional.

Në mënyrë të përmbledhur, realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Llog.	Emërtimi	Plani buxhetor vjetor	Realizimi Faktik	% e realizimit
600	Fondi i pagave	108,224,770	108,224,770	100
601	Fondi sigurimeve shoq.	18,222,000	18,124,479	99

602	Fondi shpenz operative	34,200,000	33,289,271	97
605	Fondi antar.org. ndërkomb	3,500,000	3,405,477	97
606	Fondi për ndihma ekonomike	314,000	298,000	95
602	Shpenzime nga ardhurat	10,000,000	8,238,381	82
231	Investime	8,160,000	8,045,590	99
TOTALI		182 620 770	179 625 968	98.4

5. Përmirësimi i kushteve teknike dhe operacionale të punës nëpërmjet investimeve

Në kuadër të objektivave të përcaktuara në Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe planin vjetor të institucionit, dhe në përputhje me fondet e vëna në dispozicion, DPM ka vijuar me realizimin pjesor të objektivit për zhvillimin e fushave të reja të matjes. Janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për ngritjen e kapaciteteve të reja laboratorike dhe sigurimin e gjurmueshmërisë ndërkombëtare të etaloneve kombëtare:

- i. **Blerje pajisjesh për ngritjen e laboratorit të verifikimit të radarëve të kontrollit të shpejtësisë** – me qëllim përmirësimin e kontrollit metrologjik të mjeteve për matjen e shpejtësisë në fushën e sigurisë rrugore.
 - ii. **Blerje pajisjesh për laboratorin e matjes së nivelit të zhurmës** – për të mbështetur matjet në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik.
 - iii. **Sigurimin i gjurmueshmërisë së etaloneve kombëtare dhe kalibrimin e tyre jashtë vendit** – procedurë prokurimi, e cila ka rezultuar e suksesshme vetëm për një nga lotet e tenderuara, ndërsa për pjesën tjetër do të përsëritet procesi për shkak të mungesës së operatorëve të interesuar.
- DPM ka planifikuar, ndjekjen dhe realizuar procedurat e prokurimit për shërbime dhe furnizime kryesore institucionale, përfshirë transportin e punonjësve, mirëmbajtjen e mjeteve dhe ambienteve, kalibrimin e etalonëve, pajisje laboratorike dhe arkivim. Në të njëjtën kohë, janë realizuar procedura prokurimi me vlerë të vogël për nevoja operative dhe funksionale të institucionit, si: shërbime IT, sigurime, mirëmbajtje infrastrukture, materiale dhe shërbime mbështetëse, si dhe blerje biletash për transport ajror ndërkombëtar në funksion të përfaqësimit institucional. Gjithashtu, është iniciuar një procedurë ankandi publik për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve, e cila aktualisht ndodhet e pezulluar për shkak të ankese, në pritje të vijimit sipas afateve ligjore.
 - Gjatë vitit 2025 DPM ka ndjekur 17 çështje gjyqësore, të cilat grupohen: 7 çështje administrative të përfunduara, kryesisht për masa administrative, gjoja dhe tituj ekzekutivë, kryesisht të paankimueshme; 1 çështje penale e përfunduar, e pushuar me vendim gjykate dhe

9 çështje në proces, duke përfshirë ato që lidhen me marrëdhënie pune, çështje kontraktore dhe detyrime financiare, si dhe çështje administrative për masa sigurimi dhe procedura përmbarimore. Ndjekja e këtyre çështjeve është realizuar në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë depozitimin e prapësimeve, provave dhe përfaqësimin institucional në të gjitha fazat procedurale. Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë vitit janë ekzekutuar dhe shlyer detyrime financiare ndaj tre kreditorëve, duke përfshirë kthime shumash, dëmshpërblime dhe shpenzime përmbarimore, duke garantuar respektimin e vendimeve dhe shmangien e detyrimeve të prapambetura.

6. Forcimi i bashkëpunimit me strukturat ndërkombëtare dhe evropiane të metrologjisë

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) është përfaqësuar gjatë këtij viti në të gjitha organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të metrologjisë (BIPM, EURAMET, EELMEC dhe OIML), përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e organizuara nga komitetet teknike të tyre. Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rritjes së kontributit institucional në këto struktura, me mbështetjen dhe miratimin e MEI, DPM ndërmori iniciativën për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë me të drejta të plota në Konferencën Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (CGPM) dhe ka filluar procedurat ligjore dhe institucionale për aderimin me të drejta të plota në CGPM, përmes ratifikimit të Konventës së Metrit. Projektligji përkatës, i shoqëruar me relacionin shpjegues është dërguar në Ministri që në 6- mujin e parë të vitit. Projektligji ka kaluar me sukses fazën e konsultimit institucional dhe pritet të miratohet brenda vitit 2026.

Gjatë vitit 2025, stafi i DPM ka marrë pjesë në komitete teknike ndërkombëtare dhe evropiane për cilësinë dhe fushat e prurjes, masës, gjatësisë dhe matjeve elektrike. Pjesëmarrja në këto aktivitete është shoqëruar me përgatitjen e raporteve të pjesëmarrjes për drejtuesit e institucionit, duke siguruar përditësimin dhe integrimin e praktikave ndërkombëtare në punën e laboratorëve.

7. Promovimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për rolin e metrologjisë

Gjatë vitit 2025, janë planifikuar dhe realizuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të koordinuar një sërë aktivitete që kanë synuar rritjen e transparencës, informimit publik dhe përmirësimin e komunikimit institucional. Janë realizuar aktivitete ndërgjegjësimi dhe promovimi në publik dhe në institucionet përkatëse për rëndësinë e metrologjisë, ndikimin e saj në jetën e përditshme dhe në sektorin ekonomik. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve ka kontribuar në rritjen e njohjes dhe besimit ndaj shërbimeve metrologjike, konkretisht:

- Është përgatitur dhe përshtatur përmbajtja informative për Ditën Botërore të Metrologjisë, si dhe është siguruar publikimi i saj në faqen zyrtare të institucionit dhe në rrjetet sociale.

- Në kuadër të bashkëpunimit me projektin e UNIDO “Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës për bimët medicinale, aromatike dhe fruta-perimet”, u prezantua materiali promovues me temë: “Detyrat, përgjegjësitë dhe roli i DPM-së”, i zhvilluar gjatë aktivitetit trajnues “Brandimi dhe Marketingu me Fokus Cilësinë”, i organizuar në Korçë dhe Shkodër, për prodhuesit rajonalë, në muajin qershor 2025.
- Në maj 2025, dy përfaqësues të DPM-së morën pjesë në aktivitetin ndërkombëtar të organizuar nga Byroja Ndërkombëtare e Peshave dhe Masave (BIPM) në Paris. Ky aktivitet shënoi 150-vjetorin e Konventës së Metrit, një moment kyç në historinë e metrologjisë globale. Shqipëria është në fazat përfundimtare të procesit të ratifikimit dhe anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare, duke i hapur rrugën pjesëmarrjes aktive në standardizimin dhe harmonizimin ndërkombëtar të matjeve.
- Në datë 18 shtator 2025, DPM organizoi një aktivitet promovues për fëmijët e Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Halluni” me temën “Nga loja tek shkenca – fëmijët njohin metrologjinë”. Në kuadër të këtij aktiviteti u organizuan lojëra edukative, u ndanë informacione interesante, si dhe u zhvilluan vizita në laboratorë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të afrojë fëmijët me botën e metrologjisë në mënyrë të thjeshtë dhe tërheqëse, duke nxitur kureshtjen dhe interesin për shkencën, si dhe duke u njohur me rëndësinë e matjeve në jetën e përditshme.
- Në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Departamenti i Fizikës, DPM organizoi Konferencën Ndërkombëtare dhe Shkollën Dimërore “Matjet, modelimi dhe shkenca e të dhënave në kërkim dhe inovacion”, e zhvilluar më 15–17 dhjetor 2025, me mbështetjen e Akademisë së Shkencave, Institutit Kombëtar të Fizikës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës. Ky aktivitet u përshëndet nga Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i DPM prezantoi rolin dhe veprimtarinë e institucionit, kuadrin ligjor në fushën e metrologjisë, laboratorët e etaloneve kombëtare të matjeve, si dhe prioritetet dhe drejtimit kryesore të punës në vijim. Konferenca mbledhi akademikë dhe studiues ndërkombëtarë, të cilët prezantuan punime kërkimore dhe arritje shkencore në fushat e matjeve, modelimit dhe analizës së të dhënave, duke kontribuar në shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe akademik. Ky aktivitet ka rëndësi të veçantë për forcimin e lidhjes midis kërkimit shkencor dhe praktikës institucionale në fushën e metrologjisë, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike, si dhe për nxitjen e inovacionit dhe përafrimin me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
- Gjatë vitit 2025 u krijua Muzeu i Metrologjisë në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për evidentimin e trashëgimisë së instrumentave të matjes në Shqipëri.
- Është botuar periodikisht buletini “Metrologjia”.

- Në mënyrë të vazhdueshme janë publikuar informacione mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e DPM në platformat sociale dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Vlen të theksohet se këto rezultate pozitive në punë, marri rëndësi më të madhe në kushtet e punës me 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione vakante.

Duke vijuar me një qasje reformuese dhe përafrimi me institucionet ndërkombëtare homologe. Në përfundim, gjatë vitit 2025, DPM ka përmbushur objektivat e planifikuara dhe ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit të kuadrit ligjor për metrologjinë me acquis të Bashkimit Evropian, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike, si dhe ka përparuar në bashkëpunimin ndërkombëtar. Këto përpjekje janë thelbësore për garantimin e sigurisë së instrumenteve matëse në tregun shqiptar, për mbrojtjen e konsumatorit dhe për përparimin drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian.

Me konsideratë,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Llaka

